

**VENDIM**  
**Nr. 8, datë 15.1.2026**

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË  
“INFO-TELECOM” SHPK PËR RINOVIMIN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E  
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “e”, 5, pika 1, germa “e”, 10, pikat 1 dhe 3, si dhe 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.1.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 133 prot., datë 13.1.2026, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘INFO-telecom’ sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “INFO-telecom” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 147, datë 24.6.2021, me afat licence deri më 24.6.2026.

- Në nenin 16, pika 1, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, përcaktohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 6 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë (data e përfundimit të licencës nr. 491, seria T21, është 24.6.2026) dhe shoqëria duhet të aplikonte brenda datës 24.12.2025.

- Shoqëria ka paraqitur kërkesën për rinovimin e kësaj licence, me shkresën e saj nr. 99 prot., datë 23.12.2025, e cila është protokolluar në ERE, me nr. 2984/1 prot., datë 29.12.2025. Gjithashtu, rezulton se pagesa për rinovimin e licencës është kryer në datën 18.12.2025, pra konstatohet se shoqëria e ka paraqitur aplikimin e saj brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1 të rregullores.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.

- Për sa depozituar nga shoqëria dhe në referencë të përcaktimeve të rregullores, vlerësohet se shoqëria duhet të sqarojë/plotësojë dhe sa vijon:

- deklaratën e kërkuar në germën “c”, të shtojcës 1, të rregullores dhe autorizimin për përfaqësuesin ligjor;

- strukturën organizative aktuale;

- parashikimin e sasisë së energjisë që do të tregtojë 5 vjetët e ardhshëm të ushtrimit të aktivitetit, plotësimin e planit të biznesit e, po ashtu, dedikimin e mbështetjes financiare përkatëse.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 491, seria T21, të shoqërisë “INFO-telecom” sh.p.k., për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 147, datë 24.6.2021.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “INFO-telecom” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**  
**Petrit Ahmeti**